

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Qarri kërkon hetim ndaj gjashtë deputetëve të LDK-së, Dili bën thirrje për kompromis institucional
ADRESA	https://albeu.com/kosove/qarri-kerkon-hetim-ndaj-gjashte-deputeteve-te-ldk-se-dili-ben-t-hirrje-per-kompromis-institucional/999295/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	deleted

KOHA


KAPUR NGA NE	5 shtator 2026, 14:18:52 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	5 shtator 2026, 14:14:16 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	778619e0d011de45ac5a9f82424bc5179aab20fbda55ac1a77c2eb2a43a4240f
TEKSTI	2bd66bc72cbe6d189418d15ce0d7a4d32c470ea5f10dadca8786076723f4a44b
PAMJA	0c6e0144bb7dace5c14411617295aa0efa3c57786ee11cc95f00c5e078daa473

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	92b4a4d1f157d01d778b7e4e6c1e0e8146f73793e9761c371620e166e009b2a6
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	82597d84b51b00d12dc8da6bd19ef563dde476bcf2b8ac3fbaec8c83c315f326
ANKORUAR	Polygon PoS · bllok 46991200
TRANSAKSIONI	0x4a6949f734bb917e86ef48a394a39f5e560c6ca7cb50992564901c0d93c74ab3
IPFS	QmcQ2vpHEy67KT56kkLrEBokuUFGqg7MP3SJ63znFCszpz



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/92b4a4d1f157d01d778b7e4e6c1e0e8146f73793e9761c371620e166e009b2a6>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Qarri kërkon hetim ndaj gjashtë deputetëve të LDK-së, Dili bën thirrje për kompromis institucional



Qëndrimi i gjashtë deputetëve të LDK-së kundër marrëveshjes aktuale politike dhe procesit të zgjedhjes së Presidentit të Republikës së Kosovës ka shkaktuar reagime të ndryshme në skenën politike. Ndërsa disa i akuzojnë për pengim të funksionimit të institucioneve dhe rrezikim të zgjedhjeve të parakohshme, të tjerë vlerësojnë se deputetët kanë të drejtë kushtetuese të shprehin qëndrimin e tyre.

Debati është përqendruar te përgjegjësia e të gjitha palëve dhe te nevoja për një zgjidhje politike që do të shmange një bllokadë të re institucionale. Zgjedhja e Presidentit, sipas këtij këndvështrimi, duhet të shërbejë si mundësi për kompromis dhe stabilitet, e jo si shkak për thellimin e krizës.

Qarri: Gjashtë deputetët po synojnë ta pamundësojnë zgjedhjen e Presidentit

Analisti politik Gani Qarri, në një prononcim për "Bota sot", ka komentuar zhvillimet e fundit politike dhe kundërshtimin e gjashtë deputetëve të LDK-së ndaj marrëveshjes aktuale.

Qarri i ka quajtur ata "6 rebelët e dështuar parapolitik të LDK-së". Sipas tij, deputetët nuk po e kundërshtojnë vetëm kandidatin e propozuar nga kryetari i partisë, Lumir Abdixhiku, dhe bartësen e listës së LDK-së, Vjosa Osmani, por po përpiqen gjithashtu të prishin balancën politike të krijuar, për të cilën, siç shprehet ai, kanë punuar gjatë Abdixhiku, Osmani dhe kryeministri në detyrë, Albin Kurti.

Ai ka pretenduar se veprimet e tyre mund të pamundësojnë sigurimin e kuorumit në seancën parlamentare dhe ta pengojnë zgjedhjen e prof. dr. Bekim Sejdiut në postin e Presidentit të Republikës. Sipas Qarrit, një situatë e tillë do ta shtynte Kosovën drejt zgjedhjeve të parakohshme.

Qarri ka deklaruar se gjashtë deputetët, sipas informacioneve që ai thotë se janë bërë publike deri tani, nuk e

të fundit /



Nis Kategoria e Parë, në fushë gjashtë skuadra mes tyre...



Laçi kërkon të befasojë Teutën, ndërsa ekipi i Tetovës ndjek Egnati...



Krimi në Itali/ Ish-partneri e hodhi nga mbikalimi dhe më pa...



Flick konfirmon zgjedhjen e Barcelonës për rolin e numrit 9



LSDM: Klekovski dhe Mickoski po dështojnë në menaxhimin e krizës...



Pacoli: Gjykata vendosi masë sigurie për mbi 68 ari pronë të...



Milani identifikon tre kandidatë për përforsimin e qendrës...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

kanë ideuar dhe vendosur vetë këtë veprim. Ai e ka krahasuar situatën me vitin 2020, kur, sipas tij, LDK-ja dhe partnerët e saj e rrëzuan Qeverinë Kurti pas ultimatumit të Richard Grenellit.

Sipas analistit, deputetët po veprojnë kundër interesave të qytetarëve dhe të shtetit të Kosovës, ndërsa i ka akuzuar se janë shndërruar në mbështetës të qëndrimeve të Grenellit. Qarri ka theksuar gjithashtu se Grenelli e ka përshëndetur dhe mbështetur publikisht edhe këtë veprim të deputetëve të LDK-së.

Ai ka vijuar kritikën duke thënë se kjo është hera e dytë, sipas tij, që gjashtë deputetët veprojnë në dëm të Kosovës dhe qytetarëve të saj. Qarri i ka akuzuar se po keqpërdorin mandatin e marrë nga votuesit dhe se po pengojnë funksionimin e shtetit, ndonëse paguhen nga taksat e qytetarëve.

Analisti ka ngritur edhe dyshime për ndikime të mundshme nga jashtë, duke përmendur Richard Grenellin dhe Serbinë. Ai ka pretenduar se deputetët mund të jenë duke vepruar drejtpërdrejt ose tërthorazi në përputhje me interesat e Grenellit dhe me dëshirat e presidentit serb, Aleksandër Vuçiq.



Qarri ka përmendur se më 15 shkurt 2023, në Ditën e Shtetësisë së Serbisë, Grenelli është dekoruar nga Vuçiqi me "Urdhrin e Flamurit Serb", një prej medaljeve më të larta të ndara nga Qeveria dhe shteti i Serbisë për kontributin në forcimin e marrëdhënieve miqësore ndërmjet Serbisë dhe ShBA-ve. Sipas tij, në një festë të ardhshme të shtetësisë së Serbisë mund të dekorohen edhe gjashtë deputetët e LDK-së për bllokimin e zgjedhjes së Presidentit, lënien e Kosovës pa institucione dhe qeverisje stabile, si dhe shtryjen e vendit drejt zgjedhjeve të parakohshme.

Qarri ka shprehur gjithashtu dyshime se deputetët mund të jenë nën presion ose shantazh dhe se, për këtë arsye, mund të jenë të detyruar ta vazhdojnë atë që ai e ka cilësuar si "mision antishtetëror e antikombëtar". Ai ka deklaruar se kjo situatë mund të bëjë që deputetët të mos reflektojnë dhe të mos kontribuojnë për zgjedhjen e Presidentit.

Sipas tij, deputetët mund ta mbajnë vendin në bllokadë deri në përfundimin e mandatit të tyre. Qarri e ka cilësuar mandatin e tyre si të përfutur "total gabimisht" dhe ka kritikuar veprimet që, sipas tij, janë kundër qytetarëve dhe shtetit të Kosovës.

Në përfundim, Qarri ka kërkuar që Prokuroria Speciale dhe Agjencia e Kosovës për Inteligjencë, AKI, të hetojnë veprimet e gjashtë deputetëve. Ai ka thënë se, në kohën kur po zbulohen dhe arrestohen gjithnjë e më shumë persona të dyshuar si spiunë të BIA-s dhe bashkëpunëtorë të Serbisë, institucionet e drejtësisë dhe të sigurisë duhet të përcaktojnë nëse veprimet politike të deputetëve kanë qenë në përputhje me ligjin dhe Kushtetutën apo nëse përbëjnë akte penale kundër shtetit dhe interesave të qytetarëve të Kosovës.

Dili: Është herët të paragjykohet qëndrimi i gjashtë deputetëve



Analisti Visar Dili ka dhënë gjithashtu një vlerësim për "Bota sot" lidhur me qëndrimin e gjashtë deputetëve të LDK-së dhe procesin e zgjedhjes së Presidentit të Kosovës.

Dili ka theksuar se nuk është ende e qartë se cili do të jetë qëndrimi përfundimtar i deputetëve. Ai ka vlerësuar se rëndësia e zgjedhjes së Presidentit për funksionimin institucional të vendit kërkon përgjegjësi politike nga të gjitha palët dhe gatishmëri për kompromis.

Ai nuk e ka cilësuar domosdoshmërisht situatën si "mbajtje peng të vendit", pasi deputetët kanë mandat kushtetues dhe të drejtën për të shprehur pozicionin e tyre. Megjithatë, Dili ka paralajmëruar se, nëse mospajtimet vazhdojnë pa një përpjekje serioze për zgjidhje, pasojat politike dhe institucionale do t'i bartë i gjithë vendi.

Për qëllimet e gjashtë deputetëve, analisti ka thënë se nuk mund të bëhen vlerësime të sakta pa i dëgjuar ata drejtpërdrejt dhe pa pasur një qëndrim të qartë prej tyre. Sipas Dilit, arsytet e tyre mund të jenë politike, parimore ose strategjike, por këto duhet t'i sqarojnë vetë deputetët.

Dili ka përfunduar se fokusi i politikës duhet të jetë gjetja e një zgjidhjeje institucionale. Sipas tij, Presidenti nuk duhet të kthehet në shkak të bllokimit të institucioneve, por në një pikënisje për ndërtimin e kompromisit politik dhe ruajtjen e stabilitetit të vendit.

Shtuar më 5.09.2026 16:14

Tags: [kosova](#), [presidenti](#), [Zgjedhja](#)



Pacolli: Gjykata vendosi masë sigurie për mbi 68 ari pronë të Universitetit të...



Kusari-Lila: Gjashtë deputetët e LDK-së kundërshtojnë Kurtin, jo...



Avni Islami: Deklaratat e BIA-s tregojnë se Kosova është objektiv i luftës...



PDK-ja dhe Aleanca: Shtyrja e seancës konstituive shkel...



UP: Gjykata vendos masë sigurie për 68 ari në zonën e fakulteteve teknike



Bytyçi: Sanksionet ndaj Rusisë tregojnë orientimin përëndimor të Kosovës,...



Hamza paralajmëron fazë të re veprimi të PDK-së për rikthimin e ligjshmërisë



Kosova dhe Zvicra shqyrtojnë zgjerimin e bashkëpunimit në ekono...



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.